

Kopshti

- Ka vende ku fëmijët shkojnë në shkollë edhe para se të mbushin 6 vjeç. Në Baden-Württemberg ekziston mundësia që të shkosh në **kopsht para fillimit të shkollës**. Kopshti (Kita) është forma e shkurtuar e Kindertageseinrichtung (qendër kujdesi ditore).
- Kita për fëmijët nga 3 deri në 6 vjeç njihet shpesh si **Kindergarten** (Kopsht). Kita për fëmijët nën 3 vjeç njihet shpesh si **Krippe** (çerdhe).
- Për fëmijët nga mosha një vjeç ekziston **e drejta për një vend në kopsht**. Ndjekja e kopshtit nuk është e detyrueshme. Ndjekja është me dëshirë.
- **Prindërit duhet të kërkojnë vetë një vend të lirë në kopsht dhe ta regjistrojnë fëmijën aty**. Shumicën e rasteve një vend në kopsht kushton.
- **Detyra e edukatorëve është të vëzhgojnë dhe mbështetin zhvillimin e çdo fëmije**. Edukatorët mund t'u raportojnë prindërve dhe t'u japin këshilla. Edukatorët janë profesionistë të fushës pedagogjike. Ata janë formuar për kujdesin, formimin dhe edukimin e fëmijëve.
- Në Kita fëmijën **mësojnë duke luajtur**. Aty ata mësojnë si të sillen me fëmijët e tjerë dhe si të zënë shoqëri me ta.
- Të gjithë fëmijët në Kita marrin mbështetje në mësimin e gjuhës gjermane. Ky quhet formim gjuhësor. Formimi gjuhësor zhvillohet ditën në Kita. Kur fëmija nuk flet ende gjermanisht, atë mund ta mbështetin posaçërisht me **mësimet e gjuhës gjermane**. Ky shërbim quhet **mbështetje me gjuhën**.
- Fëmijët luajnë dhe mësojnë **bashkë në grupe**. Pavarësisht gjuhës dhe kulturës, vajzat dhe djemtë vihen bashkë në grupe.
- Fëmija im duhet të jetë në Kita në **orët e caktuara**. Do të pyes se kur duhet sjellë dhe marrë. Do të flas me personelin e Kita-s se kur mund ta marr fëmijën.
- Në Kita ka një **procedurë të planifikuar ditore** nga përshëndetja deri te marrja. Këtu përfshihen: Aktivitetet, koha për lojëra të lira, dreka, pushimi, ...
- Ka Kita vetëm për paradite. Ky quhet **kujdes për gjysmë dite**. Ka Kita edhe për të gjithë ditën. Ky quhet **kujdes për gjithë ditën**.

- I shoqëruar nga nëna, babai ose një person tjetër, fëmija im mund të mësohet gradualisht me Kita-n dhe oraret. Kjo quhet **periudha e përshtatjes**. Fëmija duhet që në fillim të mos qëndrojë shumë gjatë si fëmijët e tjerë.
- Do të informohem se cilat **veshje janë të përshtatshme**.
- Unë i jap fëmijës çdo ditë **ushqim me vete** ("Vesper"). Ky është një vakt me ushqime të ftohta. Ushqimi me vete hahet mes mëngjesit dhe drekës ose mes drekës dhe darkës.
- Në Kita fëmijën tim e ndihmojnë **të zhvillohet**. Edhe kur ndjekja e Kita-s nuk është detyrim, ajo është një përgatitje të mirë për shkollën.
- Nëse një fëmijë ka vonesa në zhvillim ose një paaftësi dhe ka nevojë për mbështetje të veçantë në kopsht, prindërit mund të kontaktojnë një **"Qendër të Këshillimit të Hershëm"**.
- Nëse fëmijës i duhet një kopsht ku të marrë mbështetje të posaçme pedagogjike, atëherë ai mund **të shkojë në para-shkollë**. Aty fëmijët mund të ndjekin një Kita të përgjithshme ose të përgatiten për shkollë. P.sh. prindërit mund të informohen te qendrat e mbështetjes së hershme në Kita, ...